Kolegji Pjetër Budi

NEWSLETTER

NR. 6 JANAR 2014

KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

NË KËTË NUMËR:

Kolegji "Pjetër Budi" nënshkruan marrëveshja bashkëpunimi me gjermanët 2
Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës bashkëbisedoi me studentët 3
"Avokati i Popullit: Në veri s'ka shtet 4
"Pjetër Budi" në Panairin e Karrierës 5
Studentët vizituan terminalin doganor 6
"Pjetër Budi" në punëtorinë për kualifikimet 7
Granit Xhaka u nderua me "Medaljonin e Artë" 8

dhe të tjera…

Kolegji “Pjetër Budi” nëshkruan marrëveshje bashkëpunimi me gjermanët

Studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” do të kenë mundësi që në Gjermani të kryejnë praktikën profesionale tremujore. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjes së arritur ndërmjet “Pjetër Budit” dhe Fakultetit të Makinerisë të Universitetit të Offenburgut, si dhe kompanive Ma-Tax Consulting GmbH, BEO GmbH e FAMA Sh.P.K. marrëveshja u nënshkrua të martën në Prishtinë.

Pronari i kompanisë Ma-Tax Consulting GmbH, Karl Heinz Matt, së bashku me Clemens Sexauer e Roman Bertram - pronarë të kompanisë BEO GmbH, Alfred Isele - Dekan i Fakultetit të Makinerisë të Universitetit të Offenburgut dhe Burim Neziri, bashkëpronar i kompanisë FAMA Sh.P.K. u shprehën të kënaqur me marrëveshjen e arritur, ashtu si dhe menaxhmenti i Kolegjit “Pjetër Budi”, studentët e të cilit – veçanërisht ata të programit Doganë dhe Shpedicion, do të kryejnë praktikë në Gjermani.

Kjo praktikë do të ofrohet pa pagesë, ndërkaq do të barasvlerësohet me 30 ECTS kredi, respektivisht një semestër studimi.

Marrëveshja përfshin edhe fusha të tjera të bashkëpunimit, si shkëmbim të stafit dhe përvojave shkencore profesionale nga fusha e doganës dhe shpedicionit, bashkëpunim në projektet të përbashkëta shkencore profesionale, bashkëpunimi në sferën e trajnimit dhe edukimit të stafit të Kolegjit “Pjetër Budi”, si dhe realizim të vizitave studimore në Gjermani dhe anasjelltas.

Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës bashkëbisedoi me studentët

Në kuadër të Klubit të Debatiti të Kolegjit "Pjetër Budi", me studentët e këtij institucioni të arsimit të lartë ka bashkëbiseduar Sejdi Hoxha, Kryeshef Ekzekutiv i Postës së Kosovës (PK).Hoxha ka folur për historikun, funksionimin dhe menaxhimin e PK-së.Ai ka theksuar rëndësinë dhe përparësitë e përdorimit të shërbimeve postare por, njëkohësisht, ka paralajmëruar edhe nisjen në janar të vitit të ardhshëm të shërbimeve financiare jobankare në të gjitha zyrat postare në Kosovë.

Sipas statistikave të prezantuara, Posta... arrin deri në 80% mbulueshmëri të territorit të vendit.

Kryeshefi Ekzekutiv Hoxha ka përmendur edhe sfidat me të cilat është përballur Posta... pas ndarjes nga Posta dhe Telekomi i Kosovës (PTK) sfida të cilat, sipas tij, stafi menaxhues ia ka dalë t'i tejkalojë me anë të një menaxhimi të mirë, të ngritjes së disciplinës në punë dhe të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve. Ai, po ashtu, iu ka bërë thirrje në veçanti studentëve dhe të gjithë të rinjve që t'i përdorin shërbimet postare edhe në aspektin e komunikimit.Hoxha gjatë bashkëbisedimit me studentët është ndalur edhe tek Filatelia e Postës së Kosovës dhe ka treguar për emetimin e pullave postale me tematika të ndryshme. Po ashtu, ai ka paralajmëruar se të gjitha zyrat postare në Ksovë do të pajisen brenda pak muajsh me kamera dhe alarme, në mënyrë që të parandalohet plaçkitja dhe thyerja e tyre.

Klubi i Debatit organizohet tash pesë vjet brenda Kolegjit "Pjetër Budi", me ndihmën e Organizatës Studentore të këtij institucioni të arsimit të lartë.

Avokati i Popullit: Në veri s'ka shtet

Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, ka thënë para studentëve të Kolegjit "Pjetër Budi" se shteti i Kosovës nuk funksionon në veri të vendit.

"Në pjesën veriore të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok e Leposaviq) nuk mund të flitet për ekzistim të pjesës së shtetit të rregullt, sepse nuk ka pushtet. Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës nuk kanë pushtet në pjesën veriore. Atje është një anarki e organizuar në mënyrë shtetërore nga Serbia. Ajo është anarki e kontrolluar nga Serbia. Atje nuk respektohet asnjë ligj i Kosovës", ka thënë ai gjatë një bashkëbisedimi me studentët.

Pasi ka folur për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, Kurteshi është shprehur se numri i ankesave në veri është shumë më i vogël, pasi që atje qytetarët nuk i njohin institucionet e Kosovës. Ndërkaq, lidhur me ankesat që i janë adresuar këtij institucioni, Kurteshi ka thënë se shumica vijnë ndaj ekzekutivit dhe gjyqësorit. "Prin ekzekutivi me mbi 40 për qind të ankesave, pasuar nga gjyqësori me rreth 35 për qind".

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar rreth 2000 ankesa, që është numër më i madh krahasuar me vitet e kaluara.

Kurteshi ka thënë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur, ndërkaq ka përmendur edhe sfidat me të cilat përballet institucioni gjatë punës së tij.

“Pjetër Budi” në Panairin e Karrierës

Kolegji “Pjetër Budi” është prezantuar në Panairin e Karrierës, i cili është mbajtur në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK). Studentë të “Pjetër Budit” kanë prezantuar produkte dhe ofertën e kolegjit për të pranishmit.

Ndërkohë, në mënyrë të organizuar një grup i studentëve të “Pjetër Budit” kanë vizituar panairin. Ata kanë pasur mundësinë që të njihen për së afërmi me biznese të ndryshme pjesëmarrëse në panair, respektivisht ta shfrytëzojnë mundësinë e ofruar për kryerjen e punës praktike në ndonjërën nga kompanitë.

Web faqja e “Pjetër Budit” në gjuhën angleze

Është lansuar versioni përfundimtar i web faqes së Kolegjit “Pjetër Budi” në gjuhën angleze.

Web faqja përmban informacione të ndryshme me qëllim informimin dhe plotësimin e nevojave të studentëve, si dhe të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me këtë institucion, i cili ofron studime universitare në programe specifike zhvillimore në Kosovë dhe rajon.

Për më shumë, klikoni në www.pjeterbudi.com.

Studentët vizituan terminalin doganor

Studentët e vitit të dytë të drejtimit Doganë dhe Shpedicion vizituan Terminalin e ri Doganor në Fushë Kosovë (ish-Fabrika e Amortizatorëve). Ata aty u njohën praktikisht me punën dhe procedurat e nevojshme. Vizita u bë në kuadër të punës praktike të stduentëve.

“Pjetër Budi” në punëtorinë për kualifikimet

Kolegji “Pjetër Budi” ka qenë pjesë e punëtorisë dyditore rreth ndërlidhjes së Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Gjatë punëtorisë janë shtjelluar zhvillimet e sektorit të arsimit të lartë në korrelacion me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, si dhe reflektimet e gjendjes aktuale të këtij sektori në Kosovë.

Sipas marrëveshjes së përbashkët, proceset kombëtare të referencimit në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve duhet të përdorin procedura dhe metoda transparente. Grupi Këshillues i KEK ka vendosur mbi kriteret (gjithsej 10) dhe procedurat që duhet të konsiderohen për referencimin e niveleve të kualifikimeve kombëtare në KEK. Dita e parë e punëtorisë ishte një kombinim i prezantimit të rrjedhojës së të gjithë procesit dhe prezentimit nga Departamenti i Arsimit të Lartë të MASHT. Pas prezantimeve pasuan pyetje dhe diskutime, të cilat në të njëjtën kohë ofruan informata relevante për raportin e referencimit.

Në mënyrë që të marrin më shumë njohuri për kriteret e procesit të referencimit, pjesëmarrësit u ndanë në grupe punuese dhe u organizuan diskutime rreth tyre. Në ditën e parë janë diskutuar dy kriteret e referencimit: Kriteri 1 - Përgjegjësia dhe kompetencat ligjore të të gjitha institucioneve kombëtare të përfshira në procesin e referencimit, duke përfshirë Pikën Koordinuese Kombëtare janë qartas të përcaktuara dhe të publikuara nga autoritetet publike dhe Kriteri 2 - Ekziston lidhje e qartë ndërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe përshkimit të niveleve sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Në ditën e dytë të punëtorisë, ndërkaq, u shtjelluan edhe kriteret tjera të referencimit që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë, rezultate të pritura në arsimin e lartë, diplomat etj. Po ashtu, për pjesëmarrësit prezantoi edhe Agjencia Kosovare e Akreditimit. Prezantimi u fokusua në sigurimin e jashtëm të cilësisë tek institucionet e arsimit të lartë.

Granit Xhaka u nderua me “Medaljonin e Artë”

Me motivacionin “Për mjeshtrinë e dëshmuar në artin e futbollit dhe promovimin e shtetit të Kosovës në botë”, Kolegji “Pjetër Budi” e ka nderuar sot me Çmimin Vjetor “Medaljoni i Artë” futbollistin Granit Xhaka. Pas pranimit të çmimit nga Dekani i Kolegjit, prof.dr. Nuhi Rexhepi, Xhaka ka bashkëbiseduar me studentët në kuadër të “Klubit të Debatit” të “Pjetër Budit”.

Pasi rrëfeu rrugën e tij të suksesshme në futbollin profesionist Xhaka tha se, pavarësisht se ka lindur në Zvicër, çdoherë kur ka kohë të lirë, atë e shfrytëzon për të ardhur në Kosovë.

Duke folur për të ardhmen e tij, ai u shpreh se sapo Kosova të pranohet në FIFA dhe UEFA do t’i bashkohet Përfaqësueses së Kosovës, bashkë edhe me kosovarë të tjerë që luajnë futboll nëpër klube të njohura europiane dhe botërore.

Ndërkaq, duke konfirmuar ofertat nga klube të njohura europiane, Xhaka theksoi se deri në vitin 2017 ka kontratë me Borussia Muenchengladbach dhe se dëshiron që të jetë në formën më të mirë për Kupën e Botës që do të zhvillohet në Brazil dhe më pas do të vendosë për të ardhmen e tij.

"Deri pas Kupës së Botës do të jem në këtë skuadër më pas do të shohim se çka do të ndodhë", theksoi ai.

Xhaka, bashkë me pesë lojtarë të tjerë shqiptarë do të jetë pjesë e Përfaqëueses së Zvicrës në Botërorin 2014.

Ai është përgjigjur edhe në pyetjet që kishin të bënin me etiketimet e ndryshme negative që i janë bërë atij dhe futbollistëve të tjerë shqiptarë të Zvicrës pas ndeshjes me Shqipërinë, pastaj për idhujt e tij në futboll dhe klubet e preferuara, si dhe për jetën private.

Në "Pjetër Budi" u shënua Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Me një ligjëratë të Adem Demaçit dhe shfaqjen e filmit dokumentar "Dear Mandela", në Kolegjin "Pjetër Budi" është shënuar 10 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Aktivitetet e organizuara nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) dhe "Pjetër Budi" kanë mbledhur një numër të madh studentësh dhe të interesuarish të tjerë.

Gjatë ligjëratës së tij Demaçi ka folur për rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut, ndërkohë që nëpërmjet rrëfimit të jetës së vet ka shpjeguar se si nga një shtet, i janë shkelur të drejtat një populli të tërë. "Është nder i madh që dikush, i cili është vetë i shtypur, të luftojë për të drejtat e njeriut", theksoi ai.

Po ashtu, Demaçi ka folur edhe për Nelson Mandelën, i cili ndërroi jetë javën e kaluar.

"Bota po ndahet vetëm fizikisht nga Mandela", tha ai. Demaçi ka folur edhe për heronjtë, duke thënë se vetëm ai që vdes për kombin, ia vlen. "Nëse mundeni të vdisni për kombin, do ta keni më lehtë. Duke vdekur për kombin, vdes për njerëzimin. T'i vlerësojmë ata që flijohen për kombin".Me "vdekje për kombin" Demaçi nënkuptonte jo vetëm vdekjen fizike, por çdo sakrificë të gjithësecilit në të mirë të popullit dhe të mbarë njerëzimit.

I pyetur për ish-presidentin Ibrahim Rugova, Demaçi tha se ai ishte frikacak. Ndërkaq, kur iu kërkua vlerësimi për njerëzit që aktualisht jkanë në pushtet në Kosovë, Demaçi nuk dha kurrfarë cilësimi të drejtpërdrejtë pozitiv a negativ, por vetëm tha se "një numër i vogël" i atyre që kanë luftuar, "kanë devijuar rrugën"

Pas ligjëratës, për audiencën u shfaq filmi "Dear Mandela". Kolegji "Pjetër Budi", ndërkaq, paralajmëroi manifestimin "Muaji i të drejtave të njeriut", që filloi me këto aktivitete dhe do të vazhdojë me të tjera, që përfshijnë edhe ligjërata nga personalitete të tjera dhe shfaqje filmash.

Në Kolegjin "Pjetër Budi" më 23-27 dhjetor 2013 është mbajtur edicioni i 12-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut "Një Botë", i organizuar nga KMDLNJ.

U shfaq filmi “Dear Mandela”



Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në “Pjetër Budi” është shfaqur filmi “Dear Mandela”, që pasqyron luftën për të drejtat e njeriut. Filmi rrëfen se si tre të rinj nga Afrika Jugore vendosin t’i kundërvihen autoriteteve të këtij shteti, duke kundërshtuar vendimin që t’ua rrënojnë kasollet e tyre. Derisa luftojnë në mbrojtje të pronave, ata motivohen nga ish-presidenti i këtij vendi, Nelson Mandela, i cili, përveç tjerash, njihet si luftëtari më i madh i të drejtave të njeriut në botë. Këta të rinj afrikanë arrijnë që nëpërmjet këtij kundërshtimi ta sensibilizojnë opinionin botëror për fatin e tyre, dhe më pas që ta bëjnë një organizatë e cila mbron të drejtat e njeriut në Afrikën Qendrore, duke e ndjekur në përpikëri shembullin e Mandelës. Ish-presidenti afrikan, Nelson Mandela, i cili ndërroi jetë para pak javësh, ka mbajtur më se 30 vjet burg, ndërsa në varrimin e tij kanë marrë pjesë përfaqësues nga 91 shtete.

Ligjëratë për Nelson Mandelën

Në shenjë të nderimit për njeriun që ia kushtoi gjithë jetën mesazheve të paqes dhe me rastin e vdekjes së tij, Kolegji "Pjetër Budi" organizoi një ligjëratë të hapur për jetën dhe veprën e Nelson Mandelës.

Në ligjëratë u tha se, vdekja e Mandelës është një humbje e madhe jo vetëm për Afrikën e Jugut, por edhe për gjithë njerëzimin. Mandela, i cili është angazhuar me dekada për luftën kundër apartheidit, për çfarë i vuajti 27 vjet burg, ishte dhe do të mbetet simboli i paqes, i lirisë dhe i barazisë. Ai ishte dhe mbetet simboli i përpjekjeve të përgjithshme njerëzore për një botë më të mirë dhe për një botë më të drejtë. Nelson Mandela do të mbetet inspirim për brezat që janë dhe për brezat që do të vijnë. Po ashtu, gjatë ligjëratës u prezantua edhe biografia e tij.

Çmime gazetarëve që shkruan për fëmijët

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) në Kosovë organizoi në "Pjetër Budi" ceremoninë e ndarjes së çmimeve vjetore për gazetari në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Fitues të çmimeve u shpallën Eronida Mataj (Gazeta Jeta në Kosovë) për shkrimin "Më i 'forti' promovohet nga shoqëria", Alban Selimi (Gazeta Tribuna) për shkrimin "Lënë shkollat për tu martuar" dhe Blerta Aliu (Gazeta Koha Ditore) për shkrimin "Policia thotë se nuk mund ta gjejë babanë, që rrëmbeu fëmijët nga nëna". Pjesë e jurisë për zgjedhjen e fituesve ishin Evliana Berani, Astrit Gashi dhe Imer Mushkolaj.

Në "Pjetër Budi" u mbajt festivali "Një Botë"

Në Kolegjin "Pjetër Budi" gjatë një jave është mbajtur edicioni i dymbëdhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut "Një Botë". Gjatë kësaj kohe janë shfaqur 34 filma, ndërkaq janë organizuar edhe debate rreth filmave. Dokumentarët "The boy mir ten years in Afganistan" i regjisorit amerikan Phil Grabsky si dhe "The Ulysses" i realizuar në Spanjë nga Agatha Maciarek, kanë fituar çmimin kryesor të festivalit.

Juria e përbërë nga Isa Qosja, Behxhet Sh. Shala dhe Agron Shala, ka vendosur t'i shpërblejë edhe regjisorin nga Shqipëria, Saimir Kumbaron me dokumentarin "Martirët", me çmimin special për dokumentar si dhe me mirënjohje për trajtim të veçantë të temave të ndjeshme gazetaren e RTK-së, Ramize Murtezi Shala me dokumentarin e saj "Pedofilia në Kosovë" dhe regjisorin tiranas Aldi Karaj me filmin dokumentar "Buka e gurit".

Për studentët u shfaq filmi dokumentar “Tri ditë para fillimit”

Filmi dokumentar “Tri ditë para fillimit”, i autorit Arsim Lani, është shfaqur për studentët dhe stafin e Kolegjit “Pjetër Budi”.

Filmi shpalos një pjesë të rëndësishme të historisë së luftës së UÇK-së, që nis në shtëpinë e Abedin Rexhës-Sandokanit në Vojnikë të Skënderajt më 25 nëntor 1997, vazhdon me Betejën e Lludeviqit më 26 nëntor, kur edhe vritet mësuesi Halit Geci dhe përfundon ma daljen publike të UÇK-së në Llaushë, në varrimin e Gecit. Për ato ditë që shënuan një kthesë të madhe në historinë e luftës së UÇK-së dhe të Kosovës, në dokumentar flasin protagonistët e mbetur gjallë të asaj kohe dhe ata që janë në liri.

Gazetari Arsim Lani, autor i dokumentarit, tha gjatë debatit pas shfaqjes së filmit se qëllimi i realizimit të filmit ka qenë shpalosja e një pjese të luftës së UÇK-së, e cila deri më tash nuk ka qenë fort e ditur. Ai tregoi, po ashtu, për sfidat e realizmit të dokumentarit, që përfshin edhe xhirime autentike të kohës kur ngjarjet kanë ndodhur..

Ndërkaq Evliana Berani, ligjëruese në “Pjetër Budi”, e cila në vitet e paraluftës dhe të luftës ka punuar si gazetare dhe është pjesë e dokumentarit, foli për rëndësinë e trajtimit të ngjarjeve të asaj periudhe, të cilat paralajmëruan ndryshimin e madh në Kosovë, respektivisht i paraprinë luftës frontale me forcat serbe.

Dokumentari “Tri ditë para fillimit” është i pari që pasqyron ngjarjet e tre ditëve para daljes publike të UÇK-së dhe zgjat 42 minuta. Dokumentari tashmë është prezantuar në disa qendra të Kosovës dhe shfaqja e tij do të vazhdojë edhe në qendra të tjera

“Pjetër Budi” festoi në “Capital Club”

Festa e fundvitit e Kolegjit “Pjetër Budi” është mbajtur në mesin e dhjetorit. E organizuar nga Organizata Studentore, me rastin e përfundimit të vitit, party është mbajtur në “Capital Club”, ndërkaq për muzikën është përkujdesur Dj Gramo F. Përveç studentëve, në mbrëmjen argëtuese kanë qenë të pranishëm edhe profesorë dhe stafi administrativ i kolegjit.

Dhjetori festiv në “Pjetër Budi”

Gjatë gjithë muajit dhjetor, në Kolegjin “Pjetër Budi” ka mbretëruar atmosferë festive, me rastin e festave të fundvitit. Pasi që studentët kanë stolisur bredhin, për ta dhe gjithë stafin e kolegjit janë ndarë dhurata, me urimet që viti tjetër të jetë i mbarë dhe i suksesshëm.
Po ashtu, “Pjetër Budi” ka shpërndarë qindra kartolina urimi edhe për institucione vendëse e ndërkombëtare në Kosovë, si dhe për institucionet dhe organizatat partnere.

Kolegji "PJETER BUDI" College
PRISHTINË
INSTITUTI PËR STUDIME - INSTITUTE FOR STUDIES
Kolegji "Pjetër Budi" ju uron festat e fundvitit
dhe ju dëshiron çdo të mirë në vitin 2014!
"Pjetër Budi" College Wishes You a Merry
Christmas and Happy New Year 2014!
www.pjeterbudi.com
044/049 163 372
2014